

## ***Misioni i qendrës***

Ofrimi i shërbimeve sipas standarteve bashkëkohore, evidentimi dhe plotësimi i nevojave bazë për PAK, respektimi i të drejtave të përfituesve, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe integrimi i tyre në jetën sociale me qëllim shmangien e përjashtimit social, përbëjnë misionin bazë të qendrës së qendrës së zhvillimit \_\_\_\_\_

## ***Strategjia e qendrës së zhvillimit***

Veprimtaria dhe aktiviteti i institucionit bazohet në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e përfituesve, nxitjen e integritit social, përkushtimin dhe profesionalizmin e ekipit në ofrimin e shërbimeve mbi bazën e metodës multidisiplinare të përkujdesit për PAK

## ***Objektivat***

Përmirësimi dhe rritja e llojshmërisë së shërbimeve;

- Përbushja e nevojave të përfituesve;
- Mbështetja psiko-emocionale;
- Garantimi i sigurisë dhe mirëqënies;
- Integrimi në komunitet, përfshirja sociale;
- Kujdesi shëndetësor sipas nevojave specifike;
- Përmirësimi i marrëdhënieve me familjen dhe ruajtja e vazhdimësisë së kontakteve;
- Ndergjegjësimi i opinionit publik për problemeve e PAK

## ***Llojet e shërbimeve që ofrohen:***

Mbështetje psiko-sociale;

- Shërbime psiko-sociale;
- Shërbime psiko- motor;
- Fizioterapi;
- Loopedi
- Shërbimi sanitar;
- Aktivitete social-kulturore etj

### ***Marrëdhëniet e PAK me institucionin :***

PAK duhet të përmbushin detyrimet që ka vendosur institucioni të cilat janë të shprehura në rregulloren e brendshme të tij

### ***Detyrat e PAK***

Respektimi rregullores së brendshme të institucionit;

- Respektimi i dinjitetit të PAK;
- Respektimi i dinjitetit të personelit;
- Ruajtja e qetësisë në Institucion;
- Kujdesi dhe përgjegjësia e materialeve në përdorim;
- Mbajtja e higjenes personale dhe të ambientit;
- Respektimi i mënyrës së funksionimit të institucionit;

### ***PAK kanë të drejtën e:***

.Fjalës, (shprehjes së nevojave, dëshirave, preferencave );

- Respektimit të dinjitetit;
- Pjesëmarrjes në aktivitete sportive, fetare,( kisha/ xhami/ etj) ;
- Kujdesit shëndetësor dhe pjesëmarrjes në hartimin e planit individual shëndetësor;
- Njohjes së planit social individual;
- Njohjes së standarteve të përkujdesit social;
- Përfitimit të shërbimeve të barabarta;
- Respektimit të intimitetit;
- Përzgjedhjes së aktiviteteve në të cilat dëshirojnë të marrin pjesë;
- Pjesëmarrjes në planifikimin e aktiviteteve;
- Vendosjes së një orari të përshtatshëm vizitash;
- Drejta kolektive për të vendosur ngrënie, dushin orarin e fjetjes;
- Pjesëmarrjen në përcaktimin e mënyrës;
- Mbajtjes së sendeve të vogla personale me çelës në dhomë;
- Mbrojtjes nga dhuna dhe abuzimet e tjera;
- Ankimimit dhe marrja e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar;
- Vetë administrimit të të ardhurave etj.

### ***Marrëdhëniet e PAK me personelin.***

- PAK janë të detyruar të respektojnë personelin;
- PAK duhet të kryejnë detyrat që i cakton personeli.

### ***Marrëdhëniet PAK me njëri tjetrin.***

Të jenë korrekte, të sinqerta dhe miqësore midis tyre;

- Të respektojnë njëri – tjetrin;
- Të mos krijojnë situata konfliktuale;
- Të ndihmojnë shokët në situatë të vështira

### ***Personeli duhet të:***

- Kryejë me përpikmëri dhe seriozitet detyrën e tij.
- Respektoje dinjitetin dhe personalitetin e PAK;
- Ofroje shërbimet me përkushtim dhe profesionalizëm;
- Jetë serioze dhe të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- Jetë i paanshëm dhe pa paragjykime në marrëdhëniet me klientët;
- Parandalojë, shmangë dhe raportojë me transparencë rastet e abuzimeve

## **Roli dhe detyrat e specialistëve te Qendres se Zhvillimit Bulqize**

### ***1. Punonjësi social***

#### ***Punonjësit e përkudesit të PAK***

- Vlerëson gjëndjen social-ekonomike të familjes dhe grumbullon informacion për personin me aftësi të kufizuara.
- Vlerëson nevojat e PAK dhe programon në bashkëpunim me specialistët dhe kujdestarët, planin e shërbimeve social-edukativ dhe emocional të PAK,
- Krijon dhe pasuron dosjen personale të PAK ku përfshihet historia familjare, gjendja shëndetësore e PAK, dokumentat ligjore, vlerësime e specialistëve për terapitë e zhvillimit,

fotografia e PAK, si dhe aspekte të zhvillimit të shërbimeve dhe vlerësimet e vazhdueshme të PAK në procesin e dhënies së shërbimeve,

- Bashkërendon punën ndërmjet specialistëve të personelit, organizon aktivitetet argëtuese me PAK, kontrollon ambientet dhe pajisjet që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve,
- Informon familjen për rezultatet dhe nevojat e PAK gjatë shërbimeve në qendër,
- Menazhon planin e aktiviteteve që do të zhvillohen me PAK brenda dhe jashtë institucionit.
- Bashkërendon punën midis drejtorisë dhe specialistëve të qendrës,
- Vlerëson nevojat e komunitetit për shërbime, sensibilizon opinionin dhe kërkon mbështetje për të plotësuar nevojat e PAK;
- Mban lidhjen me njësinë bashkiake, Shërbimin Social Shtetëror, dërgon informacion për ecurinë e shërbimeve dhe ekspozon nevojat dhe problemet që duhen zgjidhur,
- Koordinon punën me qendrat e tjera të PAK brenda dhe jashtë vendit dhe me organizata të ndryshme që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar.
- Identifikojnë me aftësi të kufizuar që në moshë të hershme, të cilët kanë prapambetje mendore apo veshitësi në të mësuar, probleme emotive, fizike apo në sjellje, dhe përcaktojnë shërbimet për të përmirësuar aftësitë e tyre.
- Ndhimojnë prindërit të identifikojnë programet për këtë kategori dhe ofrojnë shërbime bazë shëndetësore ;
- Rekomandojnë mësuesit e edukimit me parashkollorë për të ofruar kujdesin individual që ata të kapërcejnë vështirësitë.
- Punonjësit social ndjekin nevojat bazë të fëmijëve, organizojnë aktivitete që nxisin zhvillimin fizik, emotiv, intelektual dhe social të fëmijës.
- Ndhimojnë të eksplorojnë interesat e tyre, të zhvillojnë talentet dhe pavarësinë, të rrisin vetëvlerësimin dhe të mësojnë si të sillen me të tjerët.
- Më qendrat e përkujdesit, punonjësit sociale ofrojnë këshillim për PAK që marrin terapi për shqetësime fizike dhe për kujdesin e përditshëm jetësor,

Ofrojnë shërbime për fëmijet me probleme mendore dhe emotive.

- Shërbimet përfshijnë terapinë në grup, terapinë individuale, metoda, dhe ndërhyrje në rast krize, rehabilitim social dhe trajnim për aftësimin e tyre për jetesë të pavarur.
- Ofrojnë shërbime mbështetëse për të lehtësuar kthimin e individëve në komunitet.

## ***2. Psikologu***

Psikologu është figura kryesore që përcakton nivelin e inteligjencës së moshës mendore të personave me aftësi të kufizuar dhe:

- Vlerëson nivelin e zhvillimit mendor të fëmijës për motorikën fine e globale, gjendjen emocionale e klinike të fëmijës, gjuhën, sjelljen, shqisat, të dhënat për gjatësinë, peshën, situatën neurologjike, neuromotorike,
- Luan rol kryesor në përcaktimin e programit dhe realizimit të tij për zhvillimin mendor të fëmijës: të kuptuarit, përqëndrimin, nivelin emocional, aftësitë shprehëse, shkallën e gjykimit dhe të arsyetimit;
- Përcakton nevojat në bashkëpunim me punonjës social, terapistët, fizioterapistin, ortofonistin dhe kujdestarët dhe harton programet e zhvillimit për riaftësimin e PAK përcakton ngarkesën që mund të përballojë klienti në disiplina të ndryshme dhe aktivitetet që do të zhvillohen në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor të tij,
- Në bashkëpunim me ekspertët e tjerë sugjerojnë metodat dhe mjetet e punës që do të përdoren dhe aktivitetet integruese që do të zhvillohen,
- Përgatit dosjen e ecurisë së fëmijës në të cilën përfshihet: gjendja emocionale e fëmijës, sjellja sociale, gjuha, komunikimi, zhvillimi i shqisave etj;
- Vlerëson periodikisht arritjet në procesin mësimor, aftësimin e fëmijëve nëpërmjet programeve të vetëshërbimit dhe veprimtaritë për integrimin e tyre dhe i vendos në dosjen e tij.
- Vlerëson në fund të çdo viti progresin për: sjelljen, autonominë, motriçitetin, orientimin në hapësirë dhe kohë, zhvillimin e ndjeshmërisë, të folurit dhe komunikimin, të mësuarit, veprimtaritë në atelietë e punës dhe tendencat e zhvillimit të personalitetit dhe i vendos në dosjen e tij.
- Ndërhyn në rastet e veçanta psikike të fëmijëve dhe përcakton shkaqet e gjendjes dhe mënyrat e trajtimit të tij;
- Përcakton rregullat dhe marrdhëniet e personelit të qendrës, me fëmijën, me prindin, dhe komunitetin.

## ***Logopedi***

Logopedia është një profesion i specializuar në parandalimin dhe trajtimin e çrregullimeve të folurit dhe të komunikimit tek PAK, , dhe tek adultët.

Logopedisti trajton PAK, me vonesa për të folur të cilët nuk mundën të shprehen nëpërmjet fjalës ose shkrimit ose të kuptojnë fjalën ose shkrimin.

Vlerësimin e hollësishëm të problemeve që lidhen me niveli gjuhësor dhe aftësitë e të mësuarit të PAK dhe mbi këtë bazë përcakton nevojat dhe harton programet për zhvillimin gjuhësor dhe të mësuarin i cili mbështetet në ekzaminime si:

- Probleme të shfaqjen së buzëqeshjes; defiçite në aftësitë pamore dhe të kontaktit okulomotor;
- Belbëzim jospontan dhe ngadalësi të zhvillimit artikulues;
- Probleme të memorjes dhe mangësi dëgjimore,
- Ngadalësi në zhvillimin e fjalorit dhe vështirësi në nivelin semantik e morfosemantik
- Probleme në të kuptuarit e formave të ndërlikuara dhe përdorimin e përemrave, kohëve të foljeve, parafjalëve, etj.

*Detyrat kryesore të Logopedistit kanë të bëjnë ne:*

- Vlerësimin e nivelit të dëgjimit dhe mësuarit,
- Referimin e pikave okulomodore dhe të pikave të referimit: tingull- hapësirë –kohë të cilat ndikojnë njëherësh në zhvillimin e fëmijës;
- Këshillimin e prindërit për zbatimin e standarteve specifike të sjelljes me fëmijën,
- Nxitjen e fëmijës të shprehet me gojë, duke i lënë kohë atij për të dhënë përgjigje;
- Nxitjen e sistemit të edukimit që të shqiptuarit dhe artikulimi të hamonizohen me zhvillimine memorjes dëgjimore;

*Shërbimet e Logopedise*

- Harton planin e trajtimit dhe rekomandon mënyrat e komunikimit me fëmijën;
- Përcakton fushen dhe komponentët e zhvillimit që të fillojmë me ushtrimin e të kuptuarit të objekteve të ndryshme;
- Përcakton zhvillimin e seancave ushtrimore dhe organizon grupet mësimore në varësi me nivelin e të kuptuarit dhe të mësuarit të personave me aftësi të kufizuar;

## ***Fizioterapisti***

- Vlerëson nevojat dhe përcakton masat dhe veprimet për përmirësimin e parametrave fizike e psikik të PAK
- Fizioterapia si disiplinë e veçantë, përfshin gjimnastikën, aerobinë, danc-terapinë për riaftësimin gjymtyrëve, nëpërmjet ushtrime fizike në sallën e fizioterapisë të cilat forcojnë ekuilibrin e PAK,
- Shërbimet ushtrimore në sallën e fizioterapisë synojnë tensionimin e muskujve të dëmtuar për të rritur ndjeshmërinë e nervave lëvizore, përmes seancave ushtrimore në kombinatin profesional, tapet, stola, krevatin e posaçëm etj.
- Shërbimet rehabilituese të gjymtyrëve në vegla në sallën e fizioterapisë kombinohen dhe ushtrime gjimnastekore në ambientet natyrore në gropën e rërës dhe mjete të buta profesionale si qese rëre, qese mielli, plasteline, topa sfungjeri etj,
- Shërbimet për ndihmën motorike synojnë përvetësimin e qëndrimit vertikal, ecjen e hershme, lëvizshmëri të gjymtyrëve të poshtme, shkathtësi të lëvizjes dhe rritjen e volumit respirator;
- Zhvillimin dhe progresin në ecje dhe sigurimin e qëndrueshmërisë vertebrale të PAK,
- Zhvillimin e sistemit motor të fëmijës drejt personi të zakonshëm,
- Zhvillimin e fëmijës për të realizuar gjestet e duhura në përputhje me rregullat dhe nivelin e zhvillimit të fëmijës,
- Realizimin e zhvillimit psikomotor të fëmijës nëpërmjet shërbimeve që ofrohen nga specialistët dhe kujdestarët,
- Asistentët e fizioterapisë kryejnë procedurë të terapisë fizike dhe ofrojnë shërbime që ndihmojnë në përmirësimin e lëvizjeve dhe çlirimin e dhimbjeve,
- Shërbimet e fizioterapisë parandalojnë dhe kufizojnë vuajtjen e individëve me AK nga dhimbja e mesit, artriti, sëmundjet e zemrës , fraktura, dëmtime në kokë, etj,
- Shërbimet dhe procedurat e terapisë si ushtrime, masazhe ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së PAK,

Një nga detyrat kryesore mbi të cilët mbështetet dhe puna e spëcialistëve të Qendrës së Zhvillimit është hartimi I RNV (raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurinë për PAK). Ky raport vlerësimi hartohet nga specialistët e Qendrës cdo 3 mujor duke u bazuar ne fushat ku kanë nevojë për ndërhyrje dhe ecurinë e zhvillimit të fëmijës.